# DËSHMI ARKIVI

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

**A-435862**
VERSIONI

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | “Akuzat e Dick Marty-t nuk çuan askund”/ Hashim Thaçi intervistë ekskluzive për Top Story: Serbia e nisi luftën. Kosova u mbrojt nga shfarosja |
| ADRESA | `https://top-channel.tv/2026/09/10/akuzat-e-dick-marty-t-nuk-cuan-askund-hashim-thaci-intervistw-ekskluzive-per-top-story-serbia-e-nisi-luften-kosova-u-mbrojt-nga-shfarosja/` |
| BURIMI | top-channel.tv |
| GJENDJA | edited |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 10 shtator 2026, 20:42:35 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| LEXUAR NGA FAQJA | 10 shtator 2026, 20:41:47 UTC<br>*Portali nuk e deklaron datën në asnjë formë makinë-lexueshme; kjo është ora e shkruar për njeriun, e lexuar nga faqja me metodën **text_date**. Dritarja: 10 shtator 2026, 20:41:00 UTC → 10 shtator 2026, 20:42:35 UTC. Kalon nga një rregull i yni që mund të gabojë, prandaj shfaqet si e lexuar dhe jo si e deklaruar.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `cbc20701bc7a69484b3d9f1ea11ef1d366c2d6ea59dae8c67315f48cf9ae34bb` |
| TEKSTI | `178ef952b0abde3f64c455af618603b65e82eaa2ca8edb7eabbcd408037b5aa3` |
| PAMJA | `a973124feac9723ff239363b0e990e922f57ebd3324089fab265879ffd16549a` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `acd29a71ca7d27abc13f295fedfb63a92f1ededd6212e6f067f0332c5b02b53e` |
| E MËPARSHMJA | `2d5e5760abc5b153987c4e9565daba217118faad9586781fbc8cdb997c7e7d31` |
| RRËNJA MERKLE | – |
| ANKORIMI | nuk është ankoruar ende<br>*Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/acd29a71ca7d27abc13f295fedfb63a92f1ededd6212e6f067f0332c5b02b53e`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored · dritarja 1280×1024 px

# “Akuzat e Dick Marty-t nuk çuan askund”/ Hashim Thaçi intervistë ekskluzive për Top Story: Serbia e nisi luftën. Kosova u mbrojt nga shfarosja

10/09/2026 22:42

Në një intervistë nga Haga në ‘Top Story’, ish presidenti Hashim Thaçi hodhi poshtë akuzat për trafikim organesh të ngritura pas raportit të Dick Marty-t, duke i cilësuar hetimet si një justifikim për themelimin e Gjykatës Speciale.

Thaçi argumenton se UÇK-ja është hetuar dhe gjykuar më shumë se çdo palë tjetër e konfliktit, ndërsa thekson se lufta në Kosovë ishte një përpjekje për vetëmbrojtje ndaj represionit dhe masakrave serbe.

Duke iu referuar edhe rolit të tij gjatë luftës, ai shprehu se u kthye nga Perëndimi për t’iu bashkuar rezistencës shqiptare dhe se veprimtaria e tij ka qenë gjithmonë transparente.

*“Hetimet rreth akuzave të Dick Marty-t për gjoja trafikim organesh nuk çuan as gjëkundi. Ato ishin thjesht një justifikim për themelimin e kësaj gjykate. Për gati gjashtë vite kemi dëgjuar riciklime akuzash, të trajtuara tash e tri dekada nëpër institucione të ndryshme të drejtësisë ndërkombëtare, pastaj edhe në ato vendore dhe ato serbe. UÇK-ja është më e hetuara dhe më e gjykuara nga të gjitha palët ndërluftuese në territorin e ish Jugosllavisë. Në anën tjetër, ajo ishte më bashkëpunuesja me drejtësinë ndërkombëtare nga të gjithë.*

*Diçka nuk përputhet këtu.*

*E vërteta është se shtypja historike dhe masakrat serbe ndaj shqiptarëve e masivizuan UÇK-në si reagim vetëmbrojtës popullor. Kujtojmë masakrat e shkurtit dhe marsit të vitit 1998 në Drenicë. Këtë fakt e konfirmojnë dhe i dhanë jehonë edhe diplomatët botërorë.*

*Serbia e nisi luftën. Kosova u mbrojt nga shfarosja. Të njëjtën gjë disa vite më parë e kishin bërë kroatët, boshnjakët dhe sllovenët përballë Serbisë. Siç po bëjnë sot edhe ukrainasit përballë agresorit rus.*

*U ktheva në Kosovë nga Perëndimi, atëherë kur jo pak njerëz mendonin se Kosova po jepte shpirt. U ktheva për t’iu bashkuar rezistencës shqiptare. Tani po akuzohem sikur kthimi im paska ndikuar për të ndezur hovin dhe masivizuar rezistencën. Çdoherë dhe gjithë aktiviteti im ka qenë transparent, për popullin e Kosovës dhe mekanizmat ndërkombëtarë”*, u shpreh Thaçi.

**Top Channel**

Nga ndërhyrja te Trump te Samiti i NATO-s/ Thaçi për Ramën: I jam mirënjohës nga zemra, pres një gjykim të pandikuar nga askush
10/09 23:00
Champions League/ Bayerni i jep shuplakë Bodos, United nuk kursehet me debutuesit, Como shkëlqen ndaj Leipzig (Video)
10/09 22:57
Top Story/ "Zgjodhëm të keqen më të vogël për Kosovën", Hashim Thaçi për Gjykatën Speciale: E shmangëm Rusinë, sot po paguaj çmimin në lëkurën time
10/09 22:44
"Shumë shpejt do i japim fund historisë së pajustifikueshme të rindërtimit", Rama me tone të ashpra për Veliajn: Prerja e kokës së kryeqytetit, eksperimenti më i rëndë social
10/09 22:35
"Ambasadori amerikan do të zbarkojë në Shqipëri", Buzhala paralajmëron në "Top Story": Ai do ta zgjidhë çështjen "Balluku"
10/09 22:20
25 vite pas sulmit të 11 shtatorit/ Sekretet e rënies së Al-Qaeda-s, nga inteligjenca te përplasja me ISIS-in
10/09 22:17
Top Story »
Nga ndërhyrja te Trump te Samiti i NATO-s/ Thaçi për Ramën: I jam mirënjohës nga zemra, pres një gjykim të pandikuar nga askush
10/09 23:00
Top Story/ "Zgjodhëm të keqen më të vogël për Kosovën", Hashim Thaçi për Gjykatën Speciale: E shmangëm Rusinë, sot po paguaj çmimin në lëkurën time
10/09 22:44
"Ambasadori amerikan do të zbarkojë në Shqipëri", Buzhala paralajmëron në "Top Story": Ai do ta zgjidhë çështjen "Balluku"
10/09 22:20
Karamuço në Top Story: Kreu i SPAK po mentoron dosjen Balluku, deri në tetor-nëntor pritet nëse do shkojë në gjyq
10/09 22:17
A do të ketë masa të reja ndaj Ballukut? Karamuço në "Top Story": Mund të jemi para një komunikimi akuze, por…
10/09 21:55
Akuza e SPAK se bleu në mënyrë fiktive vilën e Ballukut, vëllai i Igli Tares ndërhyn në Top Story: Ka qenë e Iglit, Abazi kërkoi t'ia blinte
10/09 21:51
Na ndiqni:
Top Channel @topchannelalbania @tchbreakingnews Top Channel
Video »
Top Channel/ Tirana 103 ditë mes protestave, të shtunën bashkohet edhe diaspora
Top Channel/ Hashim Thaçi kërkesë Ramës nga Haga, rrëfimi i rrallë për luftën
Top Channel/ Frika nga përmbytjet, banorët e ish-Kënetës ngrihen në protestë
Top News- Presidenti sfidon ushtarët në shtangë/ Me kostum, kreu i shtetit mongol ngre 100 kilogramë
Top News-Shqiptari abuzon mbesën 8-vjeçare/Tmerr në Korfuz, ngjarja u zbulua rastësisht nga një mjek
Top News- Çmendet moti! Stuhia e frikshme lë pas viktima e shkatërrim në pak orë
Kryesore
Akuza e SPAK se bleu në mënyrë fiktive vilën e Ballukut, vëllai i Igli Tares ndërhyn në Top Story: Ka qenë e Iglit, Abazi kërkoi t'ia blinte
21:51
Program i ri për strehimin, Qeveria prezanton 6 skema për familjet e reja dhe shtresën e mesme, 4 mijë përfitues
19:58
Top Story/ "Zgjodhëm të keqen më të vogël për Kosovën", Hashim Thaçi për Gjykatën Speciale: E shmangëm Rusinë, sot po paguaj çmimin në lëkurën time
22:44
"Jam princesha jote e vogël, të dua"/ I dërgonte foto dhe video intime të dënuarit për vrasje, oficerja 23-vjeçare i shpëton burgut
18:03
Video/ I pagabueshëm nga pika e bardhë e penalltisë, Jasir Asani shënon sërish dhe i dërgon sinjale Maran para ndeshjeve me Kombëtaren
20:58
Më të lexuarat
Vrau shqiptarin dhe e dogji brenda makinës, merr kthesë krimi makabër, familja në agoni pas detajeve të reja
"Jam princesha jote e vogël, të dua"/ I dërgonte foto dhe video intime të dënuarit për vrasje, oficerja 23-vjeçare i shpëton burgut
Kontrolle në Lezhë, bllokohet 'bisha' "Rolls-Royce", nis hetimi pasuror për pronarin
Gjyqi në Hagë, Prokuroria kërkon dënim me 6 vjet burgim për Thaçin, zbardhet akuza
"Pesë mijë dollarë për çdo amerikan të rritur nëse fitojmë zgjedhjet e mesmandatit"/ Vance: Tarifat nuk mjaftojnë për premtimin e Presidentit
Zbehet "ëndrra europiane"/ Kontinenti i vjetër nuk është më i lakmueshëm, bien me 17% kërkesat për azil në BE
I mori jetën 13-vjeçares shqiptare duke e hedhur nga ballkoni, gjykata jep vendimin e papritur për vrasësin e Aurora Tilës
"Shumë shpejt do i japim fund historisë së pajustifikueshme të rindërtimit", Rama me tone të ashpra për Veliajn: Prerja e kokës së kryeqytetit, eksperimenti më i rëndë social
Sot gjyqi në Hagë, Prokuroria: Thaçi tentoi ta pengonte procesin gjyqësor duke ndikuar te dëshmitarët
"Rama më shkruan edhe në 12 apo 1 të natës"/ Dashnor Sula në "Shqipëria Live": Nga skema me mishin te kontrollet e karburanteve

- Lajme
- Lajmet e fundit
- Politikë
- Kronikë
- Aktualitet
- Ekonomi
- Sociale
- Video
- Top News LIVE

- Bota
- Opinion
- Koment
- Kosova dhe Rajoni
- Shkencë dhe Teknologji
- Auto

- Sport
- Kombëtarja
- Kategoria Superiore
- Kategoria e Parë
- Premier League
- La Liga
- Serie A
- Shumësportësh
- Sport Gossip

- Pop News
- Showbiz

© Top Channel 2001 - 2026 • Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i përmbajtjes së kësaj faqeje.

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.